

Vendim nr. 224 datë 22.09.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 22.09.2025 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 11 (P) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **POLO SINO**, përfaqësuar nga avokate Suela Hyseni, me prokurë të përgjithshme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 793, datë 20.01.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; nr. 10-2020-648 (108), datë 27.05.2020 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2024-1898, datë 21.11.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 18, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, 141 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka paraqitur kallëzim penal ndaj disa personave, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, i cili është regjistruar me nr. 983, datë 23.04.2019 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan (*Prokuroria e Elbasanit*). Sipas kallëzimit, personat e kallëzuar kanë falsifikuar dokumente që kishin të bënin me faktin e paraqitjes së tij (kërkuesit) në komisione mjeko-ligjore dhe lëshimin prej tyre të tre raporteve mjekësore në datat 06.01.1982 dhe 08.01.1982, kohë kur ai ka qenë oficer aktiv në Forcat e Armatosura, si dhe në datën 18.01.1984, pasi ishte liruar nga kjo detyrë (më 15.02.1982), pa pasur ai dijeni, pa paraqitur kërkesë dhe pa marrë pjesë në ato komisione, raporte mjeko-ligjore mbi të cilat, në vijim, ka dalë edhe vendimi për pensionin e invaliditetit. Falsifikimet, sipas kërkuesit, ishin kryer nga shtetasi I.V. (burri i motrës së tij), në bashkëpunim me ish-bashkëshorten e tij S.R. dhe shtetasin R.R., ndërsa dokumentet e falsifikuara ishin zbuluar nga ai gjatë viteve 2015-2016, pasi në atë kohë i janë vënë në dispozicion.

2. Pas kryerjes së veprimeve verifikuese të kallëzimit Prokuroria e Elbasanit, me vendimin e datës 07.05.2019, bazuar në nenet 290, pika 1, shkronja “e” dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin e kërkuesit për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal (*KP*). Sipas këtij vendimi, dokumentet e pretenduara si të falsifikuara janë prodhuar në vitet 1983-1990 dhe janë përdorur në institucionet e qytetit të Beratit, ku kallëzuesi ka pasur vendbanimin deri në vitin 1997. Pavarësisht këtij fakti, prokuroria ka vlerësuar se edhe nëse këto dokumente do të ishin të falsifikuara, vepra penale është parashkruar për shkak të kalimit të afateve të përcaktuara në nenin 66 të KP-së, ndaj, për rrjedhojë, nuk janë kushtet ligjore për fillimin e procedimit penal. Kundër vendimit të prokurorisë kërkuesi ka paraqitur ankim në gjykatë.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 793, datë 20.01.2020, ka vendosur rrëzimin e ankimit të kërkuesit ndaj vendimit të Prokurorisë së Elbasanit për mosfillimin e procedimit penal, duke vlerësuar edhe ajo se referuar parashikimeve të nenit 66, shkronja “c”, të KP-së, afati i parashkrimit për veprën penale të kallëzuar është 10 vjet, afat i cili, në rastin konkret, ka kaluar. Në këto kushte, sipas gjykatës, prokuroria nuk mund të fillojë ndjekjen penale, pasi nuk plotësohen kushtet për fillimin e një procedimi penal, ndaj, për rrjedhojë, vendimi i prokurorit është i drejtë dhe i bazuar në ligj. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

4. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2020-648 (108), datë 27.05.2020, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë me arsyetimin se ai është marrë në zbatim të drejtë të ligjit dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi, pasi shkaqet e ngritura në ankim nuk qëndrojnë. Edhe kjo gjykatë, në të njëjtën linjë me gjykatën e shkallës së parë, ka vlerësuar se vepra penale për të cilën ka paraqitur kallëzim kërkuesi është parashkruar në referim të nenit 66 të KP-së dhe në këto kushte vendimi i prokurorit për mosfillimin e procedimit penal është i drejtë dhe i bazuar në ligj. Edhe kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në datën 26.06.2020, si dhe shtesë rekursi në datat 28.06.2022 dhe 24.07.2024.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1898, datë 21.11.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit me arsyetimin se, përtej faktit se ligji në fuqi në kohën e depozitimit nuk parashikon ushtrimin e këtij mjeti ankimi, rekursi në rastin në shqyrtim nuk përmban asnjë nga shkaqet që parashikohen në nenin 432 të KPP-së. Sipas atij kolegji, vendimi i gjykatës së apelit është i bazuar dhe i arsyetuar në përputhje me kërkesat e ligjit procedural penal dhe për pretendimet e kërkuesit, të cilat janë të njëjta me shkaqet e paraqitura në rekurs, gjykata e apelit ka mbajtur qëndrim të njëjtë me gjykatën e shkallës së parë, duke arsyetuar në mënyrë shteruese për to. Po kështu, sipas Kolegjit Penal, nuk konstatohen shkelje ose zbatim i gabuar i ligjit penal material ose procedural nga ana e asaj gjykate me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; nuk verifikohen shkelje të ligjit procedural penal me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; ose shkelje të tilla procedurale që të kenë ndikuar në dhënien e vendimit; si dhe nuk rezulton që vendimmarrja e gjykatave të faktit të jetë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

6. Në datën 16.06.2025 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), i cili, pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 27.06.2025. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr.8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të:

- 7.1. *Së drejtës së aksesit dhe së drejtës së mbrojtjes të lidhur me parimin e barazisë së armëve*, pasi prokuroria dhe gjykatat nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për të verifikuar veprimet ose mosveprimet e kryera nga personat e kallëzuar nga ai. Në aktin e lirimit të tij nga detyra e oficerit të vitit 1982 nuk është përcaktuar që lirimi të jetë bërë për shkaqe shëndetësore. Po kështu, raporti i parë mjeko-ligjor është përpiluar nga mjekë kardiologë, patologë e reumatologë, pa kompetencë në përpilimin e tyre, ndërsa raporti tjetër në vijim, po i vitit 1982, nuk mban shënim të mjekut që e ka hartuar. Edhe sipas vërtetimit nr. 1219, datë 22.06.1984 të Komandës së Repartit Ushtarak Delvinë, prej muajit shtator 1980 e deri më 01.03.1982 të shërbimit në atë repart, ai nuk ka dalë në komision mjeko-ligjor. Prokuroria nuk ka kryer hetime të plota dhe të gjithanshme dhe për këtë shkak nuk mund të arrihet në përfundimin se fakti është parashkruar nga ligji si vepër penale. Prokuroria duhet të përcaktonte personin i cili ka hapur dosjen për përfitimin e pensionit të invaliditetit dhe mbi bazën e cilave dokumente është hapur ajo, të hetonte raportet mjeko-ligjore, komisionet e kryera në Berat dhe në Vlorë, të merret informacion për ekzekutimin e vendimit të gjykatës për pensionin ushqimor dhe të pyeste në cilësinë e dëshmitarëve personat e kallëzuar.
- 7.2. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga ai i mbajtur në raste të ngjashme dhe nuk i ka dhënë zgjidhje çështjes, pavarësisht provave të paraqitura prej tij.
- 7.3. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat e zakonshme nuk kanë arsyetuar vendimet e tyre, por janë mjaftuar me citimin e neneve të KPP-së. Nga njëra anë, gjykata e apelit ka arritur në konkluzionin se ndjekja penale është parashkruar dhe prokuroria nuk mund të fillojë ndjekjen penale, pasi nuk plotësohen kushtet për fillimin e një procedimi penal dhe, nga ana tjetër, Gjykata e Lartë arrin në përfundimin se nuk ndodhet përpara rasteve të përcaktuara në nenin 432 të KPP-së. Kjo gjykatë nuk ka dhënë asnjë argument për pretendimet e ngritura në rekurs, duke mos treguar kujdesin e veçantë të kërkuar nga KEDNJ-ja. Kjo gjykatë, në kundërshtim me çfarë provohet në dosjen gjyqësore, ka arritur në konkluzionin se janë kryer veprimet e duhura verifikuese nga gjykatat e faktit pa dhënë asnjë argument se cilat kanë qenë këto veprime.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesës

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individ duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se kërkuuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor penal që ka vendosur për pushimin e procedimit penal të regjistruar mbi kallëzimin penal të paraqitur nga ai. Për rrjedhojë, nga pikëpamja procedurale, kërkuuesi e justifikon interesin e tij në çështjen e parashtruar, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ku janë dhënë vendimet e kundërshtuara.

10. Për sa i përket aspektit substancial të legjitimitetit *ratione personae*, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se individ, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si dhe të tregojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkuuesi duhet të justifikojë interesin kushtetues për çështjen e parashtruar përpara Gjykatës, pra se cenimi i të drejtave themelore prej vendimeve gjyqësore të kundërshtuara është vetjak, i drejtpërdrejtë dhe real.

11. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor, në përfundim të të cilit është vendosur pushimi i procedimit penal, duke kundërshtuar në thelb mosndjekjen penale të personave të kallëzuar prej tij se kanë falsifikuar dokumente që datojnë në vitet 1982 - 1990, mbi bazën e të cilave atij i është dhënë pension invaliditeti. Kërkuuesi nuk

ka pretendime për dhënien e këtij pensioni, por vetëm për sa i përket shkakut të tij, duke kundërshtuar në thelb sëmundjen e pasqyruar në aktet mjekësore të kohës, gjë që, sipas tij, përbën edhe veprën penale të falsifikimit të dokumenteve. Në lidhje me këtë, gjykatat e zakonshme kanë arritur në përfundimin se edhe nëse ato dokumente mjekësore do të ishin të falsifikuara, ndjekja penale nuk mund të fillonte për shkak të parashkrimit të veprës penale.

12. Për sa më lart, Kolegji çmon se ndonëse në themel pretendimet e kërkuarit kanë të bëjnë me të dhënat personale (në thelb, me ndreqjen ose fshirjen e sëmundjes së pasqyruar në aktet mjekësore të kohës), ato nuk lidhen drejtpërdrejt me procesin penal të vënë në lëvizje nëpërmjet kallëzimit kundër disa shtetasve. Në rrethanat e rastit konkret, procesi penal duket se nuk mund të sjellë pasojat materiale që kërkuari synon, përveçse ai as nuk e kushtëzon kërkuarin në përdorimin e mjeteve ligjore për mbrojtjen e të drejtave substanciale (civile) që ai pretendon se i janë shkelur. Nga ana tjetër, Kushtetuta dhe KEDNJ-ja nuk garantojnë të drejtën për të filluar ndjekjen penale kundër personave të tretë ose për dënimin e tyre (*shih vendimin e GJEDNJ-së Renata McKay-Kopecka kundër Polonisë, 2006*).

13. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se kallëzimi penal ndaj personave të tretë nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar interesin e kërkuarit në çështjen kushtetuese të parashtruar, në kuptimin që vendimet dhe procesi i kundërshtuar të sjellin pasoja reale dhe të drejtpërdrejta në të drejtat dhe liritë themelore individuale të tij. Për rrjedhojë, kërkuari nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës.

14. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.